

UDHËZIM
Nr.394, datë 3.11.2011

MBI PROCEDURAT E PAJISJES ME PASAPORTË BIOMETRIKE TË SHTETASVE SHQIPTARË

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, ligjit nr. 9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e “Kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të SAGEM Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, si dhe nenit 6 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar,

Me qëllim unifikimin dhe standardizimin e procedurave që ndiqen nga zyrat e gjendjes civile, kompania “ALEAT”, strukturat e Policisë së Shtetit, për pajisjen e shtetasve me pasaportë biometrike, në funksion të parandalimit të veprimtarisë kriminale që lidhet me falsifikimin, shpërdorimin e detyrës etj. dhe të vënies para përgjegjësisë ligjore të personave përgjegjës,

UDHËZOJ:

1. Shtetasit shqiptarë aplikojnë për pasaportë biometrike në zyrat e gjendjes civile pranë bashkive/komunave/njërive bashkiake ku ndodhet regjistri themeltar i shtetasit që do të aplikojë dhe duhet të kenë me vete një fotografi me përmasa 4x5 cm, e cila vendoset nga punonjësi i gjendjes civile në formularin e aplikimit.

2. Punonjësi i zyrës së gjendjes civile i kërkon shtetasit/es aplikues për pajisjen me pasaportë biometrike, paraqitjen e dokumentit të identitetit ose certifikatës me fotografi për personat nën 16 vjeç dhe më pas fillon intervistën me shtetasin (mbi gjeneralitetet, apo të dhëna të tjera) dhe pasi bindet se është personi i njëjtë, i jep shtetasit formularin (vetëdeklarim i të dhënave personale) model 1, pjesë e këtij udhëzimi (i cili mbahet në dy kopje të njëjta), ku në prezencë të punonjësit të gjendjes civile shtetasi e plotëson formularin e vetëdeklarimit, duke vendosur të dhëna të sakta dhe duke e nënshkruar atë.

3. Punonjësi i zyrës së gjendjes civile, në prezencë të qytetarit, nëpërmjet të dhënave të formularit të vetëdeklarimit, bën verifikimin me të dhënat e regjistrit themeltar të gjendjes civile dhe në qoftë se ato rezultojnë të rregullta, vendos fotografinë në formular, bën vulosjen me vulën e gjendjes civile në anën e majtë të fotografisë dhe ciklimin: “Nga verifikimet në regjistrin e gjendjes civile rezulton se të dhënat e formularit të vetëdeklarimit janë të njëjta me ato të regjistrit të gjendjes civile dhe të vazhdojnë procedurat e aplikimit dhe pajisjes me pasaportë biometrike.”, duke e nënshkruar atë.

4. Punonjësi i zyrës së gjendjes civile për formularët e vetëdeklarimit, në çdo rast dërgon për verifikim brenda ditës në komisariatit e policisë, ku ka vendbanimin shtetasi aplikues, formularët e vetëdeklarimit për aplikimet e shtetasve të cilët kërkojnë të pajisen me pasaportë biometrike.

5. Komisaritet e policisë nëpërmjet ndihmës të specialistëve të hetimit dhe parandalimit të krimit, bëjnë verifikimin e shtetasit sipas të dhënave të formularit të vetëdeklarimit, autentitetin e fotografisë së vendosur në formular dhe nëse i gjen të rregullta, bën ciklimin: “Nga verifikimet nëpërmjet burimeve të ndryshme apo i kontaktuar me shtetasin, rezulton se të dhënat dhe fotografia e shtetasit në formular i përkasin të njëjtit shtetas.”, e nënshkruar prej tij, dhe nëpërmjet sekretarisë, në krahun e djathtë të fotografisë, vendoset vula e komisariatit të policisë.

6. Gjatë verifikimit punonjësi i policisë, nëpërmjet numrit të telefonit të vendosur nga shtetasi në formularin e vetëdeklarimit apo me njoftime të tjera, kur ka dyshime, për sqarim mund të thërrasë shtetasin në organin e policisë, i cili është i detyruar që t’i përgjigjet thirrjes së policisë për t’u paraqitur dhe të japë sqarimet e kërkuara nga policia.

7. Në rastet kur punonjësi i policisë, nëpërmjet burimeve të informacionit edhe nga mos paraqitja e shtetasit, kur ai e ka bërë njoftimin e tij dhe bëhet e pamundur verifikimi i tij, ai bën ciklimin: “Nga verifikimet e bëra nuk është bërë i/e mundur verifikimi i shtetasit i cili edhe pas njoftimit të policisë me telefon dhe njoftimit verbal, nuk u paraqit.”, bën njoftimin e zyrës së gjendjes

civile, për pezullimin e procedurave të aplikimit, ndërsa formularin e vetëdeklarimit, me shkresë përcjellëse ia dërgon sektorit kundër krimit financiar në drejtorinë e policisë së qarkut, për hetime të mëtejshme, për veprën penale për falsifikim të dokumentit zyrtar, në bazë të nenit 186 të Kodit Penal.

8. Në rast se nga verifikimi rezulton se të dhënat e shtetasit me fotografinë e vendosur në formular nuk janë të rregullta, dokumentet bllokohen duke përpiluar një procesverbal konstatimi dhe i dërgohen me shkresë sektorit kundër krimit financiar në drejtorinë e policisë së qarkut për hetime të mëtejshme, për veprën penale për falsifikim të dokumentit zyrtar, në bazë të nenit 186 të Kodit Penal.

9. Formularët e vetëdeklarimit të verifikuar, komisariati i policisë i dërgon me shkresë përcjellëse të listuar, të firmosur e të vulosur nga shefi i komisariatit të policisë brenda tre ditëve, në zyrat e gjendjes civile për fillimin e procedurave të aplikimit dhe pajisjes me pasaportë biometrike dhe brenda 24 orëve për formularët e vetëdeklarimit për aplikimet me emergjencë.

10. Punonjësi i zyrës së gjendjes civile, pas konfirmimit zyrtar të bërë nga komisariati i policisë për identifikimin e gjeneraliteteve të shtetasit aplikant, përcaktuar në pikën 9 të këtij udhëzimi, pajis shtetasin me dokument (certifikatë personale) bashkëlidhur kopje të formularit të vetëdeklarimit të shtetasit, i cili paraqitet në zyrën e aplikimit të shoqërisë kontraktuese “ALEAT” për t’u pajisur me pasaportë biometrike.

11. Punonjësit e policisë, në pikat e kalimit dhe kontrollit kufitar (PKKK), në rastet kur gjatë kontrollit apo intervistimit të shtetasve të cilët hyjnë apo dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë, konstatojnë pasaporta me të dhëna apo fotografi të falsifikuara, bëjnë menjëherë bllokimin e pasaportës dhe shoqërimin e shtetasit për veprime të mëtejshme nga strukturat e specializuara të drejtorisë rajonale të kufirit dhe migracionit dhe të drejtorisë së policisë qarkut.

12. Shtetasit të cilëve i humb/vidhet apo bëhet e papërdorshme pasaporta biometrike, bëjnë denoncim me shkrim në komisariatit të policisë, i cili kryen të gjitha veprimet e nevojshme për verifikimin e rrethanave të këtij fakti dhe të autorësisë së mundshme. Komisarati i policisë, brenda tre ditëve nga marrja e denoncimit për humbje/vjedhje, pajis me vërtetimin e deklarimit të humbjes shtetasin. Mënyrat e marrjes së denoncimit dhe procedurat e pajisjes së shtetasit me vërtetim rregullohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

13. Formulari, model 1, pjesë e këtij udhëzimi, pasqyron këto të dhëna:

Emër, mbiemër, atësia, mëmësia, datë, muaji, viti i lindjes, vendbanimi, adresa e saktë dhe numri i telefonit. Formulari plotësohet me germa shtypi dhe shkrim të lexueshëm në dy kopje.

14. Dokumentacioni, formulari model 1, pjesë e këtij udhëzimi, dhe certifikata ruhen në arkivën e zyrave të gjendjes civile me afat 10 (dhjetë vjet) nga data e plotësimit të pasaportës biometrike.

15. Ndalohet, pajisja e shtetasve me pasaportë biometrike pa iu nënshtruar procedurave të mësipërme.

16. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen zyrat e gjendjes civile në bashki/komuna, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani